

VENDIM
Nr.183, datë 28.3.2007

PËR ORGANIZIMIN, SHTYPJEN DHE EMETIMIN E BILETAVE NË TRANSPORTIN RRUGOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 36, të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar dhe të nenit 12, të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006, "Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Format i biletave të transportit të udhëtarëve, në transportin rrugor, për shërbimin qytetas, ndërqytetas, rrethqytetas, si dhe transportin ndërkombëtar të udhëtarëve duhet të jetë në format standard dhe i pajisur me numrin serial përkatës.

2. Çmimi i biletave të transportit të udhëtarëve, i cili përmban edhe vlerën e TVSH-së, vendoset në përputhje me ligjin nr.7581, datë 7.7.1992 "Për çmimet dhe tarifat", të ndryshuar, si dhe me vendimin nr.146, datë 26.2.1998, "Për tarifat e transportit të udhëtarëve", të ndryshuar.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për emetimin e biletave të transportit të udhëtarëve, në transportin rrugor, për shërbimin qytetas, ndërqytetas, rrethqytetas dhe transportin ndërkombëtar të udhëtarëve. Printimi i biletave të transportit të udhëtarëve të realizohet nga organet e specializuara për prodhimin e tyre, në bazë të kontratës ndërmjet tyre dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

4. Pajisja me bileta tatimore e udhëtarëve të kryhet për të gjitha llojet e shërbimit të transportit të udhëtarëve, në transportin rrugor, përjashtuar taksitë 4+1 dhe 8+1. Matja e vëllimit të punës për taksitë 4+1 dhe 8+1 të kryhet nëpërmjet taksimetrit, me tregues fiskal.

5. Agjencitë e udhëtarëve realizojnë tërheqjen e biletave të transportit të udhëtarëve dhe të faturave përkatëse nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve apo degët e tyre në rrethe, kundrejt kostos së prodhimit të tyre.

6. Çdo fund viti kalendarik, agjencitë e transportit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar paraqesin, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, kërkesat për sasinë e biletave, për vitin e ardhshëm fiskal.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në mbështetje të nenit 36, të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", dhe të ligjit nr.8308, datë 18.3.1999, "Për transportin rrugor", nënshkruan aktmarrëveshje me shoqatat e transportit të udhëtarëve, për bashkërendimin e punës për sigurimin e zbatimit të legjislacionit në fushën e transportit rrugor.

8. Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për vitin 2007, t'i jepet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve, për emetimin e biletave të transportit, në zbatim të këtij vendimi.

9. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

10. Ngarkohet Ministria e Financave për nxjerrjen e udhëzimeve, në zbatim të këtij vendimi.

11. Ngarkohen Ministria e Financave, nëpërmjet Policisë Tatimore, në bashkëpunim me strukturat përkatëse për kontrollin e transportit të udhëtarëve, të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe të Ministrisë së Brendshme, për zbatimin e këtij vendimi, në përputhje me kompetencat dhe detyrat e tyre funksionale.

12. Pika 1.11, e vendimit nr.473, datë 29.7.1998, "Për rregullat kryesore të veprimtarisë së agjencive të transportit të udhëtarëve dhe të transportuesve që kryejnë transportin me autobus", shfuqizohet.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në datën 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha